



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1118/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Zethane Sefedini – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Lipjan, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, morri këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Zethane Sefedini – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Lipjan.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 13:55 nga parashtruesja e ankesës Zethane Sefedini (LDK) ku pretendohet se, në QV 1305E, 1302E, 1301X, 1301E, 1323E ka deklaruar se në QV1301X janë bartur votat e burrit dhe të tre fëmijëve të saj. Parashtruesja e ankesës i ka bashkangjitur deklaratat e e datës 03.12.2013 nga Fatije Krasniqi, Agim Jashanica, Brahim Jetullahu, Esat Gërgjaliu Nazmi Zeqiri dhe Musë Bytyqi, nga të cilat deklarata theksohet se kemi votuar për kandidaten Zethane Sefedini, prandaj kërkojmë rinumërimin e votave në QV 1305E, 1302E, 1301X, 1301E, 1323E.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga Zethane Sefedini (LDK), pretendohet se në QV 1305E, 1302E, 1301X, 1301E, 1323E ka pasur bartje të votave të saj në kandidatët e tjerë, mirëpo nga pretendimet ankimore si dhe nga deklaratat e deklaruesve PZAP-i nuk ka mundur që të vërtetoi se është kryer një veprim i tillë, prandaj një pretendim i tillë ankimorë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, pasi që mungojnë prova bindëse me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa

Anr. 1118/2013 më datën 06.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.